

VENDIM
Nr. 254, datë 25.3.2015

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË,
PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË PËR PARANDALIMIN, HETIMIN DHE
DËNIMIN E SHKELJEVE DOGANORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë, për ndihmën e ndërsjellë për parandalimin, hetimin dhe dënimin e shkeljeve doganore, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SERBISË PËR NDIHMËN E NDËRSJELLË PËR
PARANDALIMIN, HETIMIN DHE DËNIMIN E SHKELJEVE DOGANORE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Republikës së Serbisë (këtej e tutje referuar si “Palët Kontraktuese”),

duke konsideruar se shkeljet e legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat ekonomike, tregtare, financiare, shoqërore, industriale dhe bujqësore,

duke konsideruar se lufta ndaj shkeljeve doganore mund të jetë efektive në sajë të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet autoriteteve të tyre doganore,

duke pasur parasysh rëndësinë e vlerësimit të saktë të detyrave doganore dhe taksave të tjera të mbledhura mbi importet ose eksportet dhe të sigurimit të zbatimit të duhur të masave të ndalimit, kufizimit dhe kontrollit, duke përfshirë ato mbi zbatimin e dispozitave ligjore dhe nënligjore mbi falsifikimin e mallrave dhe markave tregtare të regjistruara,

duke konsideruar se trafiku i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope paraqet një rrezik për shëndetin publik dhe shoqërinë,

duke patur parasysh Konventën për Substancat Psikotrope të vitit 1971, si dhe Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Lëndëve Narkotike dhe Substancave Psikotrope të vitit 1988, duke përfshirë si të tilla ato të listuara në shtojcën e Konventës të lartpërmendur dhe amendamenteve pasuese,

- *duke pasur parasysh* Rekomandimin e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor për Ndihmën e Ndërsjellë Administrative, të datës 5 dhjetor 1953,

kanë rënë dakord për sa vijon:

PËRKUFIZIME
Neni 1

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

1. “Legjislacion doganor” do të nënkuptojë ligjet dhe rregulloret e zbatueshme nga Autoritetet Doganore të Palëve Kontraktuese, në lidhje me:

- importimin, eksportimin, tranzitimin dhe magazinimin e mallrave dhe kapitaleve, duke përfshirë edhe mënyrat e pagesës;

- mbledhjen, garantimin dhe kompensimin e taksave doganore dhe taksave mbi importin dhe eksportin;

- masat e ndalimit, kufizimit dhe kontrollit, duke përfshirë legjislacionin mbi kontrollin e shkëmbimeve;

- luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogave narkotike dhe substancave psikotrope,

2. “Autoritet doganor” do të thotë”: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Ministria e Financave, për Republikën e Shqipërisë dhe Administrata Doganore, Ministria e Financave, për Republikën e Serbisë.

3. “Autoritet doganor kërkues” do të thotë autoriteti doganor i një Pale Kontraktuese, i cili bën një kërkesë për ndihmë në fushën doganore.

4. “Autoritet doganor i kërkuar” do të thotë autoriteti doganor i një Pale Kontraktuese, i cili merr një kërkesë për ndihmë në çështjet doganore.

5. “Shkelje doganore” do të thotë çdo shkelje ose shkelje e mbetur në tentativë e legjislacionit doganor.

6. “Detyrime doganore dhe taksat e importit dhe eksportit” do të thotë detyrimet doganore dhe detyrimet e tjera, taksa ose pagesa të mbledhura mbi importet dhe eksportet.

7. “Dërgim i kontrolluar” do të thotë metoda e lejimit të ngarkesave të paligjshmeapo të dyshuara të substancave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve , apo substancave zëvendësuese të tyre për të hyrë, dalë ose lëvizur në territorin e shtetit të njëjës Palë Kontraktuese, apo më shumë vendeve, me dijeninë dhe nën kontrollin e autoriteteve kompetente të Palëve Kontraktuese me synim identifikimin e personave të përfshirë në kryerjen e shkeljeve.

8. “Person” do të thotë çdo person fizik ose person juridik.

9. “Të dhëna personale” do të thotë çdo lloj informacioni lidhur me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm.

10. “Drogënarkotike dhe substancë psikotrope” do të thotë çdo lloj produkti i listuar në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope të vitit 1988, duke përfshirë ato të përcaktuara në shtojcën e Konventës së sipërpërmendur dhe amendimeve pasuese.

11. “Prekursorë” do të thotë substanca kimike të kontrolluara, të cilat përdoren për prodhimin e drogave narkotike dhe substancave psikotrope, të përfshira në listat I dhe II, të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Trafikut të Paligjshëm të Drogave Narkotike dhe Substancave Psikotrope, të miratuar në Vjenë, më 20 dhjetor 1988.

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Neni 2

1. Palët Kontraktuese, nëpërmjet autoriteteve të tyre doganore dhe në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje, do t'u mundësojnë njëra-tjetrës ndihmë të ndërsjellë, sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, me qëllim që:

1) të sigurojnë se legjislacioni doganor është zbatuar në mënyrë korrekte; dhe

2) të parandalojnë, të hetojnë dhe të luftojnë shkeljet e legjislacionit doganor.

2. E gjithë ndihma në kuadrin e Marrëveshjes në fjalë nga secila Palë Kontraktuese do të jepet në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe brenda kompetencave dhe mundësive të autoritetit të vet doganor.

3. Kjo Marrëveshje synon vetëm ndihmën e ndërsjellë administrative ndërmjet Palëve Kontraktuese; dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk i japin të drejtë asnjë personi privat që të marrë, pengojë ose përjashtojë asnjë provë ose të pengojë ekzekutimin e ndonjë kërkesë.

QËLLIMI I NDIHMËS

Neni 3

1. Autoritetet Doganore do t'u mundësojnë njëra-tjetrës sipas kërkesësore me iniciativën e vet, informacione, dokumente dhe informacione të klasifikuara që do të ndihmojnë për të siguruar zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe parandalimin, hetimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore.

2. Çdo autoritet doganor,ndërkohë që është duke bërë kërkime për interes të autoritetit tjetër doganor, do të veprojë si të ishte duke punuar për veten e vet ose me kërkesë të një autoriteti tjetër shtetëror të asaj Pale.

Neni 4

1. Në përgjigje të autoritetit doganor kërkues, autoriteti doganor i kërkuar do t'i mundësojë atij gjithë informacionin në lidhje me legjislacionin e vet doganor dhe procedurat lidhur me hetimin e shkeljeve doganore.

2. Çdo autoritet doganor mund të dërgojë me iniciativën e vet ose me kërkesë çdo informacion të disponueshëm lidhur me:

- 1) teknikat e reja për zbatimin e legjislacionit doganor që kanë rezultuar të suksesshme; dhe
- 2) tendencat, mjetet apo metodat e reja të kryerjes së shkeljeve doganore.

RASTET E NDIHMËS

Neni 5

Autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese do të shkëmbejnë, mbi bazën e një kërkesë dhe pas hetimit paraprak, nëse është i nevojshëm, brenda kuadrit të dispozitave ligjore dhe nënligjore, çdo informacion që u mundëson atyre të sigurojnë grumbullimin e saktë të detyrimeve doganore dhe taksave, veçanërisht informacionin që lehtëson:

1. Përcaktimin e masës së detyrimit doganor, klasifikimin tarifor dhe origjinën e mallrave; dhe
2. Zbatimin e dispozitave lidhur me kufizimet, ndalimet dhe kontrollin.

Neni 6

Pas kërkesës, autoriteti doganor ndaj të cilit drejtohet kërkesa do të japë informacion dhe do të mbajë nën mbikëqyrje të posaçme:

1. Personat e njohur nga autoriteti doganor kërkues që kanë kryer një shkelje doganore ose dyshohen se kanë kryer diçka të tillë, veçanërisht personat që hyjnë ose dalin nga territori doganor i Palës Kontraktuese të kërkuar;

2. Mallrat në transit ose në magazinim, të njoftuara nga autoriteti doganor kërkues,se mund të jenë shkak për trafik të paligjshëm, të dyshuar për në ose nga territori doganor i Palës Kontraktuese të kërkuar;

3. Mjetet e transportit, të dyshuar nga autoriteti doganor kërkues,se janë përdorur për të kryer shkelje doganore në territorin doganor të njëres prej Palëve Kontraktuese;

4. Vendet e dyshuara nga Autoriteti Doganor Kërkues se janë përdorur për të kryer shkelje doganore në territorin doganor të secilës prej Palëve Kontraktuese.

Neni 7

1. Autoritetet doganore do t'u japin njëra-tjetrës sipas kërkesës ose me iniciativën e vet,

informacion, përfshirë edhe atë të klasifikuar, mbi transaksionet e kryera ose të planifikuara, të cilat përbëjnë një shkelje doganore.

2. Në rastet, të cilat mund të përfshijnë dëmtime thelbësore të sigurisë publike, shëndetit publik, ekonomisë ose çdo interesi tjetër jetësor të një Pale Kontraktuese, autoriteti doganor i Palës tjetër Kontraktuese do të japë informacion me iniciativën e vet sa herë që kjo të jetë e mundur.

Neni 8

1. Autoritetet doganore me iniciativën e vet ose sipas kërkesës do t'iu japin njëra-tjetrës informacionin e mëposhtëm:

2. Nëse mallrat e importuara në territorin e shtetit të Autoritetit Doganor Kërkues janë eksportuar në mënyrë të ligjshme nga territori i shtetit të Autoritetit Doganor të kërkuar, si dhe procedurat doganore, nëse ka, të cilave u nën-shtrohen këto mallra.

Neni 9

Autoritetet doganore:

1. Do të ndihmojnë njëra-tjetrën në lidhje me ekzekutimin e masave të përkohshme dhe procedimeve duke përfshirë bllokimin, vendosjen në mbikëqyrje ose sekuestrimin e pasurisë;

2. Do të trajtojnë pasurinë, të ardhurat ose mjetet e sekuestruara, si rezultat i ndihmës së mundësuar sipas kësaj Marrëveshjeje në përputhje me legjislacionin kombëtar të Palës Kontraktuese që ka nën kontroll pronën, të ardhurat ose mjetet.

DËRGIMI I KONTROLLUAR

Neni 10

Autoritetet doganore, sipas rregullimeve të ndërsjella dhe në përputhje me ligjet kombëtare respektive në fuqi, mund të zbatojnë metodën e dërgimit të kontrolluar për mallrat e paprekura, të lëvizura ose të zëvendësuara tërësisht ose pjesërisht.

DOKUMENTET DHE INFORMACIONI I KLASIFIKUAR

Neni 11

1. Dokumentet origjinale do të kërkohen vetëm në rastet kur kopjet e vërtetuara do të jenë të pamjaftueshme dhe do të kthehen sa më shpejt të jetë e mundur; të drejtat e autoritetit doganor të kërkuar ose të Palëve të treta, lidhur me to, do të mbeten të paprekura.

2. Çdo dokument, informacion, përfshirë edhe atë të klasifikuar, që do të shkëmbehet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të shoqërohet me gjithë informacionin e nevojshëm për interpretimin ose përdorimin e tyre.

PËRDORIMI I INFORMACIONIT DHE DOKUMENTET

Neni 12

1. Informacioni, komunikimet dhe dokumentet e marra në kuadër të kësaj Marrëveshjeje mund të përdoren në procedime civile, penale dhe administrative, sipas kushteve të përcaktuara nga legjislacioni respektiv i brendshëm vetëm për qëllime të kësaj Marrëveshjeje.

2. Ky lloj informacioni komunikimi dhe dokumentet mund të përdoren për qëllime të tjera vetëm pas miratimit paraprak me shkrim të Autoritetit Doganor të kërkuar dhe me kusht që ligjet kombëtare të autoritetit doganor kërkues nuk i ndalojnë këto lloj komunikimesh.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni, nuk do të zbatohen për informacionin që ka të bëjë me shkeljet lidhur me drogat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorët. Ky informacion mund t'u komunikohet autoriteteve të tjera, të cilat janë drejtpërsëdrejti të lidhura me luftën kundër trafikut të

paligjshëm të narkotikëve.

4. Dokumentet, komunikimet dhe informacioni mund të zëvendësohen kur është e mundur, nga informacioni i kompjuterizuar i prodhuar në çdo formë, por me të njëjtin qëllim.

5. Informacioni, komunikimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion të autoritetit doganor të Palës Kontraktuese kërkuese në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të gëzojë të njëjtën mbrojtje që i garanton legjislacioni kombëtar i Palës Kontraktuese kërkuese dokumenteve dhe informacioneve të së njëjtës natyrë.

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 13

Të dhënave personale të shkëmbyera nën këtë Marrëveshje do t'u sigurohet nga Palët Kontraktuese i njëjti nivel mbrojtës me atë të Palës Kontraktuese që i mundëson informacionin ose më e pakta nivelin e mbrojtjes që rrjedh nga zbatimi i parimeve të parashikuara në shtojcën bashkëngjitur "Mbrojtja e të dhënave personale", e cila është një pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

KOMUNIKIMI I KËRKESAVE

Neni 14

1. Ndihma në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të shkëmbehet drejtpërsëdrejti ndërmjet autorite-teve doganore.

2. Kërkesa për ndihmë, në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet me shkrim ose me mjete elektronike dhe do të shoqërohet me çdo dokument që mendohet si i dobishëm. Kur e kërkojnë rrethanat, kërkesa mund të bëhet edhe gojarisht. Kërkesa të tilla duhet të konfirmohen menjëherë me shkrim.

3. Kërkesat e bëra në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni duhet të përmbajnë detajet e mëposhtme:

- 1) Autoritetin doganor kërkues;
- 2) Subjektin dhe arsyen për kërkesën;
- 3) Një përshkrim të shkurtër të çështjes, elementet ligjore dhe mënyrën e procedimet.

4. Kërkesa e bërë nga autoritet doganor për një procedurë të caktuar duhet të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe dispozitat e tjera të Palës Kontraktuese të kërkuar.

5. Dokumentet, informacioni, përfshirë dhe atë të klasifikuar, i transmetuar në kuadër të kësaj marrëveshjeje do t'i njoftohen zyrës, e cila është përcaktuar për këtë qëllim nga secili autoritet doganor. Një listë e zyrtarëve të kësaj zyre do t'i vihet në dispozicion autoritetit doganor të Palës tjetër Kontraktuese.

6. Autoritetet doganore të marrin masa që zyrtarët e tyre përgjegjës për hetimin dhe luftën kundër shkeljeve doganore të mbajnëmarrëdhënie personale dhe drejtpërsëdrejti me njëri-tjetrin.

EKZEKUTIMI I KËRKESAVE

Neni 15

1. Në rastet kur autoritetet doganore nuk i kanë dokumentet apo informacionin e kërkuar, në përputhje me legjislacionin e tyre ato mund:

- 1) të iniciojnë kërkimet për zotërimin e informacionit apo dokumenteve; ose
- 2) të dërgojnë menjëherë kërkesë agjencisë përkatëse; ose
- 3) të tregojnë Autoritetet përkatëse me të cilat kanë lidhje.

2. Çdo hetim në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, përfshin marrjen e deklaratave nga

personat, përfshi dëshmitarët dhe ekspertët, që është e nevojshme të japin informacion në lidhje me një shkelje doganore.

Neni 16

1. Mbi bazën e një kërkesë me shkrim, zyrtarët e emëruar për këtë qëllim nga autoriteti doganor kërkues, me autorizim nga autoriteti doganor i kërkuar dhe duke plotësuar kushtet që ky i fundit mund të verë, për qëllime hetimi të një shkeljeje doganore, mund të:

1) hetojnë në zyrat e autoritetit doganor të kërkuar, regjistrat, dokumentet dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme për të nxjerrë informacion në lidhje me shkeljen doganore, përfshi gjithashtu edhe dëshmitarët dhe ekspertët;

2) marrin kopje të dokumenteve, regjistrave dhe çdo të dhënë tjetër të rëndësishme lidhur me shkeljen doganore;

3) jenë të pranishëm gjatë hetimit të ndërmarrë nga autoriteti doganor i kërkuar në territorin doganor të Palës Kontraktuese të kërkuar në interes të autoriteti doganor kërkues.

2. Kur zyrtarët e autoritetit doganor kërkues, janë të pranishëm në territorin e Palës tjetër, sipas dispozitave të parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, ata duhet të jenë në gjendje të paraqesin prova për të vërtetuar pozitën zyrtare të tyre.

3. Zyrtarët e autoriteti doganor kërkues, ndërkohë që janë atje, gëzojnë të njëjtën mbrojtje dhe ndihmë të njohur zyrtarëve doganore të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me ligjet në fuqi të asaj pale dhe do të jenë përgjegjës për çdo shkelje që mund të bëjnë.

EKSPERTËT DHE DËSHMITARËT

Neni 17

1. Sipas kërkesës së autoritetit doganor të një Pale Kontraktuese, autoriteti doganor i Palës tjetër Kontraktuese mund të autorizojë zyrtarët e vet, me miratimin e tyre, që të dëshmojnë si ekspertë apo dëshmitarë në gjykimet ose proceset administrative lidhur me shkelje doganore të proceduara në territorin e Shteti të Palës Kontraktuese Kërkuese dhe të përgatisin objekte, ndërmarrin veprime dhe të përgatisin dokumente të tjera ose kopje të certifikuara të këtyre të fundit të nevojshme për këto procedime. Kërkesa për paraqitje duhet, në veçanti, të përcaktojë çështjen si dhe gjithashtu statusin në të cilin është thirrur të dëshmojë zyrtari.

2. Autoriteti doganor i kërkuar duhet të përcaktojë në mënyrë të saktë, nëse i kërkohet, në autorizimin e lëshuar, kufizimet brenda të cilave zyrtarët e vet mund të dëshmojnë.

SHPENZIMET

Neni 18

1. Autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese do të heqin dorë nga të gjitha kërkesat për rimbursim të shpenzimeve të bëra gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të shpenzimeve dhe dietave për ekspertët dhe dëshmitarët, gjithashtu edhe për përkthyesit dhe interpretët, kur këta nuk janë punonjës shteti, të cilat do të mbulohen nga Autoriteti Doganor kërkues.

2. Nëse për ekzekutimin e kërkesë kërkohen ose mund të nevojiten shpenzime thelbësore dhe të një natyre të jashtëzakonshme, autoritetet doganore do të merren vesh për të përcaktuar kushtet dhe termat të cilave do t'i nënshtrohet ekzekutimi i kërkesës, si dhe për mënyrën me të cilën do të mbulohen shpenzimet.

ZBATIMI I MARRËVESHJES

Neni 19

1. Aktet ligjore për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të nxirren drejtpërsëdrejti nga autoritetet doganore të Palëve Kontraktuese.

2. Një komision i përbashkët shqiptaro-serb do të ngrihet, në përbërjen e të cilit dotë jenë drejtuesit e autoriteteve doganore të të dy Palëve Kontraktuese, ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar të asistuar nga ekspertë, që do të mbledhet sa herë të jetë e nevojshme për të parë ecurinë e Marrëveshjes, si dhe për të gjetur zgjidhje nga mosmarrëveshje që mund të lindin, në bazë të kërkesës të çdo autoriteti doganor.

3. Çështjet për të cilat nuk gjenden zgjidhje do të zgjidhen me marrëveshje të ndërsjellë ndërmjet Palëve Kontraktuese.

4. Palët Kontraktuese do të takohen, me qëllim të rishikimit të Marrëveshjes sipas kërkesës pas një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes në fuqi me përjashtim të rastit kur ato njoftojnë njëra - tjetrën me shkrim që nuk është i nevojshëm një rishikim i tillë.

SHTRIRJA TERRITORIALE

Neni 20

Marrëveshja do të zbatohet në territoret doganore të vendeve të Palëve Kontraktuese.

PËRJASHTIME

Neni 21

1. Dhënia e bashkëpunimit mund të refuzohet në rast se cenon sovranitetin, sigurinë, rendin publik ose interesa të tjera të rëndësishme të Palës Kontraktuese të kërkuar, do të përbënin një dhunim të sekreteve industriale, tregtare ose profesionale ose do të ishin në kundërshtim me legjislacionin e tij kombëtar.

2. Nëse autoriteti doganor kërkues, kërkon një ndihmë të cilën ai vetë nuk do të mund ta ofronte, do t'ia bëjë të qartë këtë fakt në kërkesën e vet. Pranimi i një kërkesë të tillë mbetet në diskrecionin e autoriteti doganor të kërkuar.

3. Ndihma mund të shtyhet nga autoriteti doganor i kërkuar nëse ajo bazohet në faktin se ndërhyr në një proces hetimi, ndjekjeje ose procedime të papërfunduar. Në këtë rast autoriteti doganor i kërkuar do të konsultohet me autoritetin doganor kërkues për të përcaktuar nëse mund të jepet ndihmë sipas termave dhe kushteve që mund të vihen nga autoriteti doganor i kërkuar.

4. Në rastet e refuzimit apo të shtyrjes së ndihmës do të jepen arsye të detajuara për refuzimin apo shtyrjen.

HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI

Neni 22

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pasi Palët Kontraktuese të njoftojnë njëra-tjetrën me një njoftim me shkrim se janë përfunduar të gjitha procedurat ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 23

1. Vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje është për një periudhë të pakufizuar kohe, por çdo Palë Kontraktuese mund të zgjidhe atë nëpërmjet një njoftimi me shkrim.

2. Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi tre muaj pas datës kur Pala tjetër Kontraktuese ka

marrë njoftimin siç parashikohet në paragrafin 1 të këtij neni.

3. Procedimet në vazhdim do të përfundojnë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të sa më sipër, përfaqësuesit nënshkrues, të autorizuar rregullisht për këtë nga Qeveritë e tyre respektive, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Beograd, më 10.11.2014, në dy ekzemplarë origjinalë, në gjuhët shqipe, serbe dhe në gjuhën angleze, të gjitha tekstet me të njëjtën vlerë autentike. Në rast mosmarrëveshjeje në interpretim e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, do të këtë përparësi gjuha angleze.

SHTOJCË MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

1. Të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik:

- 1) Do të merren dhe përpunohen me ndershmëri dhe në mënyrë ligjore;
- 2) Do të ruhen për qëllime të caktuara dhe të ligjshme dhe nuk do të përdoren në asnjë mënyrë që nuk përputhet me këto qëllime;
- 3) Do të jenë të përshtatshme dhe jo ekstreme në lidhje me qëllimet për të cilat ruhen;
- 4) Do të jenë të sakta dhe kur është e nevojshme, të rinovuara; dhe
- 5) Do të ruhen në formën që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë jo më të gjatë sesa kërkohet për qëllimet për të cilat ato të dhëna ruhen.

2. Të dhënat personale që lidhen me origjinën raciale, bindjet politike, fetare, shëndetin apo jetën seksuale, mund të mos përpunohen në mënyrë automatike nëse ligjet e brendshme nuk garantojnë sigurinë e duhur. E njëjta gjë do të zbatohet edhe për të dhënat personale në lidhje me dënimet penale.

3. Palët Kontraktuese do të marrin masat e duhura të sigurimit për mbrojtjen e të dhënave personale të ruajtura në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave ndaj çdo shkatërrimi të paautorizuar, ndryshimi apo shpërndarja e tyre.

4. Çdo personi duhet t'i krijohet mundësia:

- 1) Të përcaktojë ekzistencën e një skedari të kompjuterizuar të të dhënave personale, qëllimet kryesore që ka ky skedar, si dhe identitetin dhe vendqëndrimin e rregullt apo vendndodhjen kryesore të kontrolluesit të këtij skedari;
- 2) Të marrë në intervale të arsyeshme dhe pa vonesa apo shpenzime të tepruara, konfirmimin nëse të dhënat personale që lidhen me të janë ruajtur në skedarët e kompjuterizuar të të dhënave dhe t'i komunikohen këto të dhëna në një formë të lexueshme;
- 3) Të përfitojë sipas rastit, korrigjimin apo fshirjen e të dhënave të tilla nëse ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit të brendshëm dhe cenojnë parimet bazë të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të kësaj shtojce;

4) Të ketë një zgjidhje ligjore, nëse një kërkesë për, sipas rastit, komunikim, përshtatje, apo fshirje të dhënash siç parashikohet në nën-paragrafët 2 dhe 3 të këtij paragrafi nuk zbatohet;

5.1 Nuk lejohet asnjë përjashtim nga përshtatjet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 4 të kësaj shtojce me përjashtim të rasteve brenda kufijve të përcaktuara në parimin vijues.

5.2 Shmangia nga dispozitat e pikave 1, 2 dhe 4 të kësaj shtojce lejohet vetëm atëherë kur një shmangie të tillë parashikohet me ligj prej Palës Kontraktuese dhe përbën një masë të domosdoshme për një shoqëri demokratike dhe është në interes të:

1) mbrojtjes së sigurisë shtetërore, qetësisë publike, interesave monetare të shtetit apo dënimit e veprave penale; ose

2) mbrojtjen e subjektit të të dhënave ose të të drejtave të lirive të tjerëve.

5.3 Kufizimi për ushtrimin e të drejtave të përcaktuara në pikën 4, nënparagrafët 2, 3 dhe 4 të kësaj shtojce mund të sigurohen me ligj në rastin e dosjeve të të dhënave personale të kompjuterizuara, të

përdorura për qëllime statistikore apo për kërkime shkencore kur aty nuk ka asnjë rrezik të dukshëm për shkelje të jetës private të subjektit të të dhënave.

6. Çdo Pale Kontraktuese merr përsipër përcaktimin e sanksioneve të duhura dhe përmirësimin e ligjit të brendshëm për shkeljen e dispozitave të cilat kanë pasoja në parimet bazë të përcaktuara në këtë shtojcë.

7. Asnjë nga dispozitat e kësaj shtojce nuk do të interpretohet si kufizim apo ndikim mbi mundësitë e një Pale Kontraktuese për t'i dhënë subjektit të të dhënave një masë më të gjerë mbrojtjeje nga ajo që është përcaktuar në këtë shtojcë.